

RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E GJAKOVËS - 2025





RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E GJAKOVËS - 2025

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.67, Prizren,
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

029 222 771

Prill, 2026

Përmbajtja:

HYRJE.....	4
GJETJET E RAPORTIT.....	6
Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor.....	6
Statistikat Kryesore - 2025:	7
Korniza ligjore.....	7
Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit.....	8
Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor.....	9
Menaxhimi i mbeturinave.....	10
Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave.....	12
Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike	13
Licencimi dhe lejet mjedisore.....	14
PËRFUNDIME.....	15
REKOMANDIMET.....	16
Për EC:.....	17

HYRJE

Metodologjia për monitorimin mjedisor në nivel komunal është hartuar si instrument profesional për vlerësimin sistematik të gjendjes së mjedisit dhe funksionimit të mekanizmave institucionale në komunat e Kosovës. Dokumenti synon të krijojë një kornizë të standardizuar për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore, duke siguruar krahasueshmëri dhe koherencë ndërmjet komunave.

Kjo metodologji mbështetet në të dhëna primare të siguruar përmes pyetësorëve të strukturuar të plotësuar nga institucionet komunale përgjegjëse për çështjet mjedisore për periudhën janar - dhjetor 2025, si dhe në të dhëna sekondare të nxjerra nga raporte zyrtare komunale, dokumente institucionale dhe burime të tjera relevante që kontribuojnë në plotësimin dhe verifikimin e analizës.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit

Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës

Ligji nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Ligji nr.08/L-137 për pyjet e Kosovës

Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës

Ligji nr.04/L-060 për mbeturina dhe Ligji nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e tij

Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike

Ligji nr.08/L-065 për produktet biocide

Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë

Ligji nr.04/L-197 për kimikate

Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor

Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Metodologjia bazohet në analizën e këtyre komponentëve kryesorë të menaxhimit mjedisor:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Sistemet e monitorimit mjedisor
- Sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore
- Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Në këtë kuadër, analiza synon të trajtojë në mënyrë të strukturuar elementet kryesore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe praktikrat institucionale në nivel komunal.

Gjetjet e paraqitura në këtë dokument identifikojnë çështjet kryesore dhe sfidat aktuale në sektorin e mjedisit, duke reflektuar gjendjen reale në bazë të të dhënave të ofruara nga institucionet komunale. Këto gjetje eidentojnë nevojën për përmirësim të kapaciteteve institucionale, si dhe për forcimin e proceseve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor.

Në funksion të kësaj analize, në pjesën përfundimtare janë paraqitur rekomandime konkrete, të cilat synojnë përmirësimin e praktikave ekzistuese dhe avancimin e menaxhimit mjedisor në nivel komunal, drejt një qasjeje më të qëndrueshme dhe efektive në mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore.

GJETJET E RAPORTIT

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Gjakovës, përgjegjësitë për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor janë të organizuara në kuadër të dy strukturave kryesore institucionale:

- Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUMM)
- Drejtoria e Shërbimeve Publike (DShP)

Në kuadër të DUMM funksionon Sektori për Mbrojtje të Mjedisit, i përbërë nga një udhëheqës sektori dhe një zyrtar mjedisor.

Në kuadër të DShP funksionon Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit, ndërsa drejtoria ka gjithsej 6 punonjës, prej të cilëve 3 janë të angazhuar në këtë sektor.

Organi komunal	A është themeluar	Emri zyrtar	Fuqia punëtore
Drejtoria	Po	Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	/
Sektori	Po	Sektori për Mbrojtje të Mjedisit	2
Drejtoria	Po	Drejtoria e Shërbimeve Publike	6
Sektori	Po	Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit	3

Tabela 1. Skema institucionale lokale për menaxhimin mjedisor

Sa i përket kapaciteteve njerëzore, evidentohet mungesë e stafit të dedikuar për çështje mjedisore. Në kuadër të DUMM, vetëm dy zyrtarë trajtojnë një gamë të gjerë të problematikave mjedisore.

Stafi vlerësohet të ketë përgatitje profesionale në nivel të mirë (4/5), mirëpo trajnimet profesionale janë të kufizuara dhe jo të strukturuar. Trajnimet rreth kornizës ligjore janë të rralla, ndërsa ato mjedisore realizohen kryesisht nga organizata të jashtme.

Statistikat kryesore - 2025:

- Numri i zyrtarëve në sektorin mjedisor: 2
- Numri i trajnimeve për kornizën ligjore: shumë i kufizuar
- Numri i trajnimeve për çështje mjedisore: sporadik
- Udhëzues profesional të përdorur: nga niveli qendror dhe organizata

Në aspektin operacional, 3 punonjës të dedikuar për menaxhimin e mbeturinave në kuadër të DShP përballen me ngarkesë të lartë pune, duke qenë se mbulojnë një territor të tërë komunal dhe një gamë të gjerë aktiviteteve (grumbullim, transport, koordinim). (Raporti Vjetor i DShP, 2025)

Kjo strukturë e kufizuar institucionale reflekton sfida të ngjashme edhe në nivel nacional, ku kapacitetet njerëzore dhe teknike në sektorin e mjedisit vlerësohen si të pamjaftueshme për menaxhim efektiv¹.

Në aspektin e zhvillimit profesional, mungesa e trajnimeve të rregullta dhe të strukturuar kufizon përditësimin e njohurive të stafit dhe ndikon në zbatimin praktik të kornizës ligjore mjedisore.

Korniza Ligjore

Komuna e Gjakovës në ushtrimin e përgjegjësive të saj në fushën e mjedisit mbështetet në një sërë ligjesh dhe dokumentesh ligjore sektoriale.

Ligjet kryesore të përdorura për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor janë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës
- Ligji për Ujërat
- Ligji për Planifikimin Hapësinor
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)

¹Raporti i AMMK për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë, publikuar në vitin 2025, linku:

<https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ALB%20Raporti%20per%20gjendjen%20e%20mbeturinave%20ne%20Kosove%202023-2024.pdf>

Korniza ligjore vlerësohet si pjesërisht e konsoliduar. Sipas të dhënave të siguruara, ekzistojnë dualizma ndërmjet ligjeve dhe mungesë e sqarimeve të mjaftueshme për zbatimin praktik të tyre.

Njohuritë e stafit lidhur me këtë kornizë janë vlerësuar në nivel të mirë (5/5). Pavarësisht nivelit të mirë të njohurive të stafit (5/5), mungesa e qartësisë në dispozitat ligjore dhe dualizmat ndërmjet ligjeve krijojnë vështirësi në interpretim dhe zbatim praktik në nivel komunal, veçanërisht në rastet që kërkojnë koordinim ndërinstytucional.

Në praktikë, zbatimi i kornizës ligjore shpesh ndikohet edhe nga ndarja e kompetencave ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror, ku një pjesë e funksioneve kyçe (si licencimi dhe lejet mjedisore) mbeten në përgjegjësi të institucioneve qendrore, duke kufizuar ndërhyrjen direkte të komunës.

Në nivel nacional, raportet tregojnë se sfidat në zbatimin e kornizës ligjore mjedisore lidhen me mungesën e udhëzimeve të qarta dhe kapaciteteve për implementim, duke reflektuar një problematikë më të gjerë institucionale në sektorin e mjedisit².

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Komuna e Gjakovës ka hartuar dokumente të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga korniza ligjore në fuqi.

Dokumentet kryesore të identifikuara përfshijnë:

- Planin Lokal të Veprimit në Mjedis
- Planin Lokal për Biodiversitet
- Planin Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave
- Planin Lokal për Cilësinë e Ajrit (në proces hartimi)

Sipas të dhënave të siguruara, strategjitë mjedisore lokale janë të harmonizuara me strategjitë e nivelit qendror.

Sa i përket zhvillimit të projekteve mjedisore, ato realizohen kryesisht përmes instrumenteve të planifikimit lokal, duke përfshirë Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Hartën Zonale Komunale (HZK), si dhe përmes planeve lokale përkatëse.

²Po aty

Masat për mbrojtjen e mjedisit nuk paraqiten si aktivitete të veçanta të ndara, por janë të integruara brenda projekteve komunale dhe dokumenteve të planifikimit.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2025 janë realizuar investime në sektorin e infrastrukturës dhe mjedisit, përfshirë:

- 350,000 € për mirëmbajtjen e gjelbërimit dhe hapësirave publike
- 550,000 € për ndërtimin dhe rregullimin e parqeve
- 65,000 € për përmirësimin e kanalizimeve
- 100,000 € për instalimin e sistemeve ujitëse³

Këto investime reflektojnë një fokus në përmirësimin e infrastrukturës publike dhe elementeve mjedisore, megjithatë nuk shoqërohen gjithmonë me masa të strukturuar për menaxhimin e qëndrueshëm mjedisor.

Kjo qasje dëshmon integrimin e komponentit mjedisor në planifikimin komunal, por në të njëjtën kohë evidenton mungesën e një ndarje të detajuar të masave specifike mjedisore në nivel operacional.

Komuna ka hartuar së paku 4 dokumente kryesore mjedisore, mirëpo mungesa e indikatorëve të matshëm dhe e një kornize të qartë monitorimi e vështirëson vlerësimin e progresit në zbatimin e tyre.

Në kuadër të Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave 2021–2025 janë përcaktuar 16 objektiva, nga të cilat një pjesë nuk janë realizuar plotësisht, duke reflektuar sfida në implementim dhe në sigurimin e burimeve financiare dhe teknike⁴.

Integrimi i komponentit mjedisor në dokumentet e përgjithshme të planifikimit (PZHK dhe HZK) kontribuon në adresimin e çështjeve mjedisore në mënyrë horizontale, por mungesa e ndarjes së masave specifike në nivel operacional kufizon efektivitetin e ndërhyrjeve konkrete.

Në nivel nacional, sfida të ngjashme janë identifikuar edhe në komunat e tjera, ku dokumentet strategjike shpesh nuk shoqërohen me mekanizma të qartë implementimi dhe monitorimi⁵.

³Raporti vjetor i Drejtorisë së Infrastrukturës Publike, Komuna e Gjakovës, 2025, linku: <https://gjakova.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Raporti-Vjetor-2025-DSHP.pdf>

⁴Po aty

⁵Raporti i AMMK për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë, publikuar në vitin 2025, linku: <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ALB%20Raporti%20per%20gjendjen%20e%20mbeturinave%20ne%20Kosove%202023-2024.pdf>

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e mjedisit realizohet në nivel komunal përmes strukturave të inspektoratit.

Sa i përket raportimit të inspektimeve, informacioni dhe dokumentimi përkatës menaxhohen nga inspektorët, ndërsa sektori i mjedisit nuk posedon evidencë të strukturuar mbi llojet dhe përmbajtjen e raporteve të inspektimit.

Nuk hartohen raporte të monitorimit të zbatimit të strategjive mjedisore.

Gjendja e deponive të mbeturinave monitorohet në mënyrë sistematike.

Nga ana tjetër, nuk janë realizuar vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese në mjedis.

Sa i përket identifikimit të çrregullimeve mjedisore nga aktivitetet e personave fizikë apo juridikë, këto çështje trajtohen në kuadër të inspektoratit dhe nuk janë të strukturuar si pjesë e raportimit nga sektori i mjedisit.

Janë identifikuar raste të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore, mirëpo këto çështje konsiderohen si kompetencë e nivelit qendror dhe jo e nivelit komunal.

Mungesa e një sistemi të strukturuar për raportimin dhe dokumentimin e inspektimeve kufizon mundësinë për analizë të trendëve dhe për ndërmarrje të masave të bazuara në evidencë në nivel komunal.

Fakti që nuk hartohen raporte të monitorimit për zbatimin e strategjive mjedisore tregon mungesë të mekanizmave të ndjekjes së progresit, duke e bërë të vështirë vlerësimin e efektivitetit të politikave të zbatuara.

Mungesa e vlerësimeve të ndikimit të deponive në mjedis përbën një boshllëk të rëndësishëm në menaxhimin mjedisor, pasi kufizon identifikimin e rreziqeve dhe ndërhyrjen në kohë për parandalimin e degradimit mjedisor⁶.

Në nivel nacional, raportet tregojnë se monitorimi dhe raportimi mjedisor mbeten ndër sfidat kryesore, veçanërisht për shkak të mungesës së sistemeve të integruara dhe kapaciteteve teknike⁷.

⁶Po aty

⁷Po aty

Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Gjakovës paraqet një ndër sektorët më të zhvilluar në aspektin e ofrimit të shërbimeve bazë, megjithatë vazhdon të përballet me sfida në avancimin e mëtejshëm të sistemit.

Sipas raportit vjetor të Drejtorisë së Infrastrukturës Publike, Komuna e Gjakovës ka arritur mbulim 100% të territorit me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave⁸.

Plani Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave përfshin gjithsej 16 objektiva, nga të cilat një pjesë nuk janë realizuar plotësisht⁹.

Stacioni transferues operon me rreth 80% të kapacitetit funksional.

Megjithatë, mbeten sfida të theksuara në menaxhimin e mbeturinave ndërtimore dhe mbeturinave të veçanta¹⁰.

Në nivel rajonal, rajoni i Gjakovës ka shënuar rënie të gjenerimit të mbeturinave për banor nga 197.91 kg/banor/vit në vitin 2023 në 178.82 kg/banor/vit në vitin 2024.

Po ashtu, sasia totale e mbeturinave ka rënë nga 30,693,000 kg në vitin 2023 në 26,541,000 kg në vitin 2024.

Mbulimi me shërbim ka qenë 100% për të dy vitet.

Në nivel nacional, sfidat kryesore lidhen me mungesën e ndarjes së mbeturinave në burim dhe menaxhimin e mbeturinave specifike.

Treguesi	2023	2024	Ndryshimi
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/vit)	197.91	178.82	-19.09
Sasia totale e mbeturinave (kg)	30,693,000	26,541,000	-4,152,000
Mbulimi me shërbim (%)	100%	100%	0

Tabela 2. Skema institucionale lokale për menaxhimin mjedisor

⁸Raporti vjetor i Drejtorisë së Infrastrukturës Publike, Komuna e Gjakovës, 2025, linku: <https://gjakova.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Raporti-Vjetor-2025-DSHP.pdf>

⁹Po aty

¹⁰Po aty

Të dhënat tregojnë një trend pozitiv në rajonin e Gjakovës, me ulje të gjenerimit të mbeturinave si për banor ashtu edhe në total.

Ky zhvillim e dallon Gjakovën nga shumica e rajoneve të tjera në Kosovë, ku është evidentuar rritje e mbeturinave.

Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, sfidat strukturore si mungesa e ndarjes në burim dhe trajtimi i mbeturinave specifike vazhdojnë të kufizojnë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

Në përgjithësi, përmirësimi i mëtejshëm kërkon fokus në rritjen e riciklimit, përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e politikave të bazuara në evidencë¹¹.

Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Gjakovës nuk ka ndërtuar sistem të strukturuar për menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Sipas të dhënave të siguruara, mungojnë kapacitetet teknike për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Në aspektin njerëzor, kapacitetet janë të kufizuara, pasi vetëm dy zyrtarë janë të angazhuar në trajtimin e të gjithë problematikës mjedisore. Ky kapacitet nuk është i mjaftueshëm për të menaxhuar, analizuar dhe trajtuar çështjet komplekse mjedisore në mënyrë efektive.

Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në mungesën e një sistemi funksional për menaxhimin e të dhënave dhe kufizon mundësinë për zhvillimin e analizave të mirëfillta mjedisore në nivel komunal.

Mungesa e një sistemi të integruar për menaxhimin e të dhënave mjedisore përbën një ndër pengesat kryesore për zhvillimin e politikave efektive në nivel lokal, pasi vendimmarrja nuk mbështetet në evidencë të plotë dhe të strukturuar.

¹¹Raporti i AMMK për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë, publikuar në vitin 2025, linku: <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ALB%20Raporti%20per%20gjendjen%20e%20mbeturinave%20ne%20Kosoves%202023-2024.pdf>

Kapaciteti i kufizuar njerëzor (2 zyrtarë) në raport me kompleksitetin e çështjeve mjedisore ndikon drejtpërdrejt në pamundësinë për mbledhje, analizë dhe interpretim të të dhënave në mënyrë sistematike.

Në nivel nacional, mungesa e sistemeve funksionale për menaxhimin e të dhënave mjedisore është identifikuar si një sfidë e përhapur, duke kufizuar zhvillimin e analizave dhe politikave të bazuara në evidencë¹².

Kjo situatë reflekton nevojën për zhvillimin e një sistemi të standardizuar për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave, i cili do të mundësonte monitorim më të mirë dhe raportim më të saktë të gjendjes mjedisore.

Komuna nuk ka sistem të strukturuar për menaxhimin e të dhënave mjedisore. Mungesa e sistemeve funksionale kufizon zhvillimin e analizave dhe politikave të bazuara në evidencë¹³.

Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore vlerësohet në nivel të ulët (2 nga 5). Sipas të dhënave të siguruara, ky bashkëpunim karakterizohet si i rrallë dhe jo domethënës.

Në mënyrë të ngjashme, bashkëpunimi me nivelin qendror në hartimin e strategjive mjedisore gjithashtu vlerësohet në nivel të ulët (2 nga 5), ku komuna ftohet rrallë ose aspak në këto procese.

Sa i përket bashkëpunimit me organizatat joqeveritare, ai vlerësohet në nivel mesatar (3 nga 5). Ky bashkëpunim zhvillohet në mënyrë të pjesshme, ku komuna në disa raste është e përfshirë në aktivitete dhe iniciativa, ndërsa në raste të tjera mungon koordinimi.

Në aspektin e pjesëmarrjes publike, komuna zhvillon procese të konsultimit publik për dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor në përputhje me kërkesat ligjore. Të gjitha dokumentet përkatëse i nënshtrohen diskutimit dhe debatit publik.

Megjithatë, niveli i pjesëmarrjes publike në këto procese vlerësohet i ulët (2 nga 5).

¹²Po aty

¹³Po aty

Licencimi dhe lejet mjedisore

Licencimi dhe dhënia e lejeve për shfrytëzimin dhe menaxhimin e resurseve mjedisore nuk janë në kompetencë të nivelit komunal.

Sipas të dhënave të siguruara, këto funksione realizohen nga institucionet e nivelit qendror.

Centralizimi i funksioneve të licencimit dhe lejeve mjedisore kufizon rolin e komunës në ndërhyrje të drejtpërdrejta, duke krijuar varësi nga institucionet qendrore për vendimmarrje dhe zbatim të masave.

Kjo ndarje e kompetencave ndikon në efikasitetin e reagimit ndaj çështjeve mjedisore në nivel lokal, veçanërisht në rastet që kërkojnë ndërhyrje të shpejtë ose njohje të kontekstit lokal.

Mungesa e mekanizmave të koordinimit efektiv ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror mund të rezultojë në vonesa në procedurat administrative dhe në zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit.

Në nivel nacional, kjo strukturë e ndarjes së kompetencave është identifikuar si sfidë për menaxhimin e integruar të mjedisit, duke theksuar nevojën për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe decentralizimin e disa funksioneve operative¹⁴.

¹⁴Po aty

PËRFUNDIME

Gjetjet e analizës tregojnë se Komuna e Gjakovës ka të themeluar strukturat bazë institucionale dhe dokumentet kryesore të planifikimit mjedisor, por përballet me sfida të konsiderueshme në zbatimin efektiv të tyre.

Kapacitetet njerëzore në sektorin e mjedisit janë të kufizuara, duke qenë se vetëm dy zyrtarë trajtojnë një gamë të gjerë të çështjeve mjedisore.

Korniza ligjore vlerësohet si pjesërisht e konsoliduar, me sfida që lidhen me dualizmin e dispozitave dhe mungesën e qartësisë në zbatim.

Në aspektin e monitorimit, nuk ekziston një sistem i integruar për monitorimin e komponentëve kryesorë mjedisorë, përfshirë ajrin, dheun dhe ujin.

Gjithashtu, mungon një sistem funksional për menaxhimin e të dhënave mjedisore, si dhe raportimi i strukturuar për zbatimin e strategjive.

Bashkëpunimi ndërinstitutional dhe përfshirja e publikut mbeten në nivele të ulëta, duke ndikuar në cilësinë e proceseve vendimmarrëse.

Në përgjithësi, megjithëse ekziston një bazë institucionale dhe ligjore, kërkohet fuqizim i kapaciteteve dhe zhvillim i mekanizmave funksionalë për të përmirësuar menaxhimin mjedisor në nivel komunal.

Gjetjet në nivel lokal përputhen me trendet e identifikuara në nivel nacional, ku mungesa e kapaciteteve, sistemeve të monitorimit dhe menaxhimit të të dhënave paraqet një sfidë të përhapur në sektorin e mjedisit¹⁵.

Kontrasti ndërmjet investimeve infrastrukturore dhe mungesës së mekanizmave funksionalë të monitorimit dhe raportimit tregon se përmirësimi i menaxhimit mjedisor kërkon jo vetëm burime financiare, por edhe forcim institucional dhe zhvillim të sistemeve të bazuara në evidencë.

¹⁵ Po aty

REKOMANDIME

- 1 Të rriten kapacitetet njerëzore në sektorin e mjedisit për të përballuar ngarkesën aktuale të punës.
- 2 Të zhvillohet një sistem i qëndrueshëm për monitorimin e komponentëve kryesorë mjedisorë (ajri, uji, dheu).
- 3 Të krijohet një sistem funksional për menaxhimin e të dhënave mjedisore.
- 4 Të përmirësohet koordinimi ndërmjet sektorit të mjedisit dhe inspektoratit për raportim më të strukturuar.
- 5 Të forcohet bashkëpunimi me nivelin qendror dhe të rritet përfshirja e publikut në proceset mjedisore.

PËR EC:

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse. Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar. Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-it synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

Deklarata e vizionit

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

Deklarata e misionit

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.

EC
MA ND RYSHE



www.ecmandryshe.org